



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 Prill 2012
Nr. ref.: AGJ.193 /12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 103/10

Parashtrues

Shaban Mustafa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shaban Mustafa, pronar i Ndërmarrjes “Beni Dona”, i përfaqësuar nga z. Hasan Përvetica, avokat nga Podujeva.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010, i cili i ishte dorëzuar më 6 tetor 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 12 tetor 2010, me të cilën kërkonte që Gjykata ta vlerësonte kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008.
4. Parashtruesi pohon që vendimi i kontestuar ia kishte shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 24.1 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesi posaçërisht pohon që Gjykata Supreme nxori një aktgjykim pa e njoftuar dhe pa e thirrur parashtruesin që të merrte pjesë në procedurë në të njëjtën mënyrë si e kishte thirrur prokurorin publik.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 12 tetor 2010.
8. Më 16 dhjetor 2010, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 103/10, e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 103/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.
9. Më 19 janar 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme për këtë kërkesë.
10. Më 22 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në Prishtinë për këtë kërkesë dhe kërkoi komentet e saj në lidhje me këtë kërkesë.
11. Më 24 janar 2012, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit u përgjigj se ata e mbështetën Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010, dhe se të drejtat e parashtruesit të garantuara me Kushtetutë nuk ishin shkelur.

12. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 7 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për pranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 16 shtator 1996, Ndërmarrja “Beni Dona”, pronë e parashtruesit, lidhi kontratë me Komunën e Podujevës për ta marrë me qira objektin e ish-hotelit “Llap” në Podujevë për një periudhë 10-vjeçare, me kusht që Ndërmarrja “Beni Dona” ta rehabilitonte atë në shpenzime të veta në shumë prej 342.760,00 markave gjermane. Pas skadimit të kontratës së qirasë, komuna e Podujevës do të vendoste për vazhdimin ose ndërprerjen e kontratës së qirasë, pra nëse komuna do të vendoste ta ndërpriste kontratën e qirasë, ajo do t’ia kthente Ndërmarrjes “Beni Dona” shumën e shpenzuar për rehabilitimin e hotelit.
14. Prej vitit 2002 deri në vitin 2005, sipas kërkesës së Komunës së Podujevës, përveç shpenzimeve për rehabilitim, Ndërmarrja “Beni Dona” e pagoi edhe tatimin në pronë për pronën e marrë me qira. Pasi këto pagesa ishin shumë të larta dhe nuk ishin paraparë me kontratë të qirasë, Ndërmarrja “Beni Dona” nuk ishte në gjendje t’i paguante dhe kërkoi nga Komuna e Podujevës të sqaronte cilat ishin obligimet e Ndërmarrjes “Beni Dona” dhe ta zgjidhte situatën qoftë duke e vazhduar kontratën e qirasë, duke zbritur në këtë mënyrë nga shuma që ndërmarrja duhet të paguante shumën prej 550 euro si qira për secilin muaj deri në barazimin e shumës së përgjithshme të shpenzimeve të rehabilitimit, ose duke ia kthyer komunës objektin e marrë me qira, e cila më pas do t’ia paguante ndërmarrjes shumën e investuar në rindërtimin e hotelit, siç përcaktohej me kontratën e 16 shtatorit 1996, që e kthyer në euro do të ishte 171.380,00 euro.
15. Pasi Komuna e Podujevës nuk iu përgjigj kërkesës së Ndërmarrjes “Beni Dona”, parashtruesi ngriti padi kundër komunës në Gjykatën Komunale në Podujevë më 6 qershor 2007, duke kërkuar që gjykata të vendoste që ose komuna t’ia kthente investimin në shumë prej 171.380,00 eurove ose që ndërmarrja të vazhdonte ta shfrytëzonte objektin e marrë me qira për dhjetë vjet, duke zbritur nga shuma e investuar një qira prej 550 eurove në muaj, derisa të barazohej shuma.
16. Më 9 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Podujevë, me Aktgjykim C. nr. 155/2007, e miratoi padinë e parashtruesit dhe i urdhëroi komunës së Podujevës ose t’ia kthente ndërmarrjes fondet e investuara ose ta vazhdonte kontratën e qirasë edhe për dhjetë vjet.
17. Komuna ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 9 nëntor 2007.
18. Më 28 maj 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 28/2008, e refuzoi si të pabazuar ankesën e komunës, duke pohuar që dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për përmbajtje dhe që, në arsyetimin e vet, gjykata kishte ofruar arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet e rëndësishme vendimtare dhe prandaj, arsyetimi i ofruar ishte plotësisht në përputhje me përmbajtjen e provave të administruara.
19. Brenda afatit ligjor, Komuna e Podujevës ushtroi revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme.

Në të njëjtën kohë, Prokurori publik paraqiti kërkesë, në të njëjtën gjykatë, për mbrojtje të ligjshmërisë, duke propozuar anulimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, dhe që rasti të rihapej në gjykatën e shkallës së parë.

20. Më 3 shtator 2010, në praninë e Prokurorit publik, Gjykata Supreme e miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori publik, si dhe revizionin e paraqitur nga Komuna e Podujevës, duke konstatuar që komuna e tani ligjërisht nuk ishte përgjegjëse për kontratën e qirasë ndërmjet parashtruesit dhe ish-kuvendit komunal të Podujevës të nënshkruar në vitin 1996. Gjykata e bazoi arsyetimin e vet ligjor në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1) dhe në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45) në kuptimin që këto rregullore të UNMIK-ut e ndryshuan statusin juridik të Komunës së Podujevës nga statusi i personit juridik në vitin 1996, kur kontrata për qira ishte nënshkruar, në një status të veçantë juridik. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi që ky ndryshim i statusit juridik të komunës i eliminoi obligimet ligjore që komuna mund të ketë pasur para miratimit të këtyre rregulloreve të UNMIK-ut. Prandaj, duke u bazuar në këtë gjendje dhe në provat e administruara, Gjykata Supreme gjeti që gjykatat e shkallëve më të ulëta gabimisht e kishin zbatuar të drejtën materiale kur kishin gjetur që padia e parashtruesit ishte e bazuar dhe kishin konkluduar që kontrata për qira e vitit 1996 ndërmjet parashtruesit dhe Komunës së Podujevës më nuk ishte ligjërisht detyruese për atë komunë.
21. Prandaj, Gjykata Supreme e miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori publik, dhe revizionin e paraqitur nga Komuna e Podujevës, duke i ndryshuar me këtë rast të dy aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pohon që arsyetimi i Gjykatës Supreme është i gabuar për shkak se konkludoi që ndërmarrja kishte lidhur kontratë me ish-Komunën e Podujevës në vitin 1996, e cila nuk e ka kontinuitetin – suksesionin e saj në vazhdimësi para dhe pas luftës, dhe, për këtë arsye, ajo komunë nuk obligohej me ligj t'i merrte përsipër obligimet e kontratës së vitit 1996. Sipas mendimit të tij, Komuna e Podujevës vërtet e ka humbur kontinuitetin politik të ish-komunës, por gëzonte kontinuitetin juridik të bartjes së të drejtave dhe detyrimeve, pasi ishte vendosur në të njëjtat lokale dhe administronte pasurinë e patundshme si edhe më parë, dhe pasi kishte pranuar se ishte pronare e objektit të lëshuar me qira, ajo duhej t'i pranonte edhe detyrimet lidhur me këtë objekt.
23. Sipas mendimit të parashtruesit, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1 nuk i shpallte të pavlefshme kontratat ekzistuese ndërmjet palëve, madje as ato në të cilat komuna ishte njëra prej palëve, pasi kontratat e tilla nuk mund të konsideroheshin “akt shtetëror” i qeverisur nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1.

24. Parashtruesi më tej pohon që Gjykata Supreme vendosi për revizionin e Komunës së Podujevës dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit publik në seancën e mbajtur më 3 shtator 2010 vetëm në praninë e Prokurorit publik të Kosovës, pa e thirrur përfaqësuesin e parashtruesit.
25. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte marrë në kundërshtim me nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 24.1 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse asnjë përfaqësues i Ndërmarrjes “Beni Dona” nuk ishte thirrur apo i pranishëm në procedurën në Gjykatën Supreme. Prandaj, sipas parashtruesit, palët në procedurë nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë.

Dispozitat e zbatueshme ligjore lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

26. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë rregullohet me Ligjin për procedurën kontestimore të 20 shtatorit 2008.

Nenet përkatëse të Ligjit (Nr. 03/L-006) për procedurën kontestimore

Neni 250:

“Për seancën në të cilën gjykata do të vendosë lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë do të njoftohet prokurori publik kompetent”.

Neni 251:

“Kur vendos për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata do të kufizohet vetëm në ekzaminimin e shkeljeve që i thekson prokurori publik në kërkesën e vet”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Parashtruesi ankohet që aktgjykimi i Gjykatës Supreme i shkeli nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 24.1 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse përveç Prokurorit publik, asnjë përfaqësues i Ndërmarrjes “Beni Dona” nuk ishte thirrur të merrte pjesë në procedurën në të cilën Gjykata Supreme kishte vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Prandaj, ai, si përfaqësues i ndërmarrjes, nuk ishte trajtuar në mënyrë të barabartë.
28. Gjykata së pari vëren që, në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, parashtruesi së pari duhet të tregojë që i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi mund të konsiderohet palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”* Përveç kësaj, sipas nenit 21.4 të Kushtetutës, *“Të drejtat dhe liritë themelore të*

përcaktuara në Kushtetutë vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme". Në kërkesën në fjalë, z. Shaban Mustafa, pronar i Ndërmarrjes "Beni Dona", e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010, të drejtuar kundër ndërmarrjes. Prandaj, parashtruesi duhet të konsiderohet si palë e autorizuar, se ka të drejtë ta ngrejë këtë çështje në Gjykatë dhe se i ka shterur të gjitha mjetet juridike, siç parashihet me ligj, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

30. Sa i përket kriterit të nenit 49 të Ligjit, se parashtruesi duhet ta ketë dorëzuar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajve që fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi përfundimtar gjyqësor, Gjykata konstaton nga parashtruesit se ndërmarrjes i ishte dorëzuar aktgjykimi i sipërpërmendur i Gjykatës Supreme më 6 tetor 2010, kurse parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 12 tetor 2010, pra brenda afatit prej katër muajve siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

31. Pasi parashtruesi ka saktësuar në detaje cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së supozohet të jenë shkelur dhe nga cili autoritet publik, Gjykata gjithashtu gjen që parashtruesi e ka përmbushur kriterin e nenit 48 të Ligjit, i cili thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

32. Në këto rrethana, Gjykata konkludon që duhet të konsiderohet se parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri dhe që tani duhet t'i shqyrtojë meritat e kërkesës.

Vlerësimi ligjor i kërkesës

33. Në rastin aktual, Gjykata vëren që Gjykata Komunale në Podujevë, me Aktgjykimin C. nr. 155/2007, e miratoi padinë e parashtruesit dhe i urdhëroi Komunës së Podujevës ose t'ia kthente ndërmarrjes fondet e investuara ose ta vazhdonte kontratën e qirasë të lidhur ndërmjet tyre edhe për dhjetë vjet. Komuna e Podujevës paraqiti ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila e hodhi poshtë ankesën më 28 maj 2008. Komuna e Podujevës paraqiti revizion kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme, ndërsa, në të njëjtën kohë, Prokurori publik paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në të njëjtën gjykatë.

34. Më 3 shtator 2010, Gjykata Supreme gjeti, me Aktgjykimin Rev. nr. 406/2008, që kërkesa e Prokurorit publik për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe revizioni i Komunës së Podujevës ishin të bazuara, dhe që nuk mund të pranohej konkluzioni ligjor i gjykatave të shkallëve më të ulëta që komuna obligohej t'i përmbushte detyrimet e një kontrate që datonte nga viti 1996, të nënshkruar ndërmjet ndërmarrjes dhe Kuvendit komunal të Podujevës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që në kohën materiale, Prokurori i shtetit – pa qenë palë në procedurë në gjykata të shkallëve më të ulëta – e ushtroi të drejtën sipas nenit 245 (2) të Ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore të

Kosovës të ngrinte, ndër të tjera, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me një vendim të gjykatës së shkallës së dytë, kundër të cilit njëra prej palëve kishte paraqitur revizion brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh që fillon të ecë që nga dita kur revizioni i ishte dorëzuar asaj pale.

36. Gjykata më tej vëren që, sipas parashtrësive të parashtruesit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 3 shtatorit 2010, ishte nxjerrë në praninë e Prokurorit publik, por pa e njoftuar dhe pa e thirrur parashtruesin që të merrte pjesë në procedurë në të njëjtën mënyrë siç e kishte thirrur Prokurorin publik. Prandaj, sipas mendimit të parashtruesit, Gjykata Supreme nuk e kishte trajtuar atë në mënyrë të barabartë dhe ia kishte shkelur të drejtën për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

37. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës ndër të tjera përcakton:

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

38. Neni 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

[...]

39. Gjykata përsërit që, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës, *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

40. Sa i përket ankesës së parashtruesit se ai nuk kishte qenë i njoftuar dhe i thirrur që të merrte pjesë në procedurën në Gjykatën Supreme, Gjykata i referohet qasjes së GJEDNJ-së në raste të ngjashme. P.sh., në rastin Grozdanoski (shih Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21510/03, i 31 majit 2007), GJEDNJ konkludoi se, në procedurën civile, parimi i barazisë së armëve do të thotë që secilës palë duhet t'i ofrohet mundësia e arsyeshme për ta paraqitur rastin e vet – duke përfshirë provat – në kushte që nuk e vejnë atë në situatë të pafavorshme përballë kundërshtarit të vet. Sipas GJEDNJ-së, koncepti i gjykimit të drejtë, një aspekt i të cilit është barazia e armëve, nënkupton të

drejtën e palëve për të pasur njohuri dhe për t'i komentuar të gjitha provat e paraqitura apo vërejtjet e parashtruara.

41. Përveç kësaj, në rastin Grozdanoski, Prokurori publik kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, por parashtruesi kurrë nuk ishte njoftuar për këtë. Kërkesa e Prokurorit publik shpuri në vendim të Gjykatës Supreme, që ishte shumë i pafavorshëm për parashtruesin. GJEDNJ konsideroi që dështimi procedural për të mos e njoftuar parashtruesin e kishte penguar atë që të merrte pjesë në mënyrë efikase në procedurë në Gjykatën Supreme të Maqedonisë.
42. GJEDNJ gjithashtu ishte e mendimit se neni 6 (1) i KEDNJ-së është i menduar, para së gjithash, për t'i siguruar interesat e palëve dhe interesat e administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, ndërsa respektimi i të drejtës për gjykim të drejtë, i garantuar me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, kërkonte që parashtruesit t'i ofrohej mundësia për të pasur njohuri dhe për ta komentuar kërkesën e Prokurorit publik. Si rrjedhojë, GJEDNJ konstatoi që dështimi për ta njoftuar parashtruesin për kërkesën e Prokurorit publik për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar në Gjykatën Supreme të Maqedonisë kishte qenë shkelje e nenit 6 (1) të KEDNJ-së.
43. Gjykata më tej i referohet rastit Gusak, (shih Gusak kundër Ruisë, 7 qershor 2011, Kërkesa nr. 28956/05, paragrafi 27), me ç'rast GJEDNJ konsideroi që *“ndërgjyqësi duhet të thirret në seancë gjyqësore jo vetëm për ta ditur datën dhe vendin e seancës, por edhe për të pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur rastin e tij dhe për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore”*.
44. Sipas mendimit të Gjykatës, prokurorët publikë, kur veprojnë jashtë fushës së të drejtës penale, duhet të gëzojnë të drejta dhe obligime të njëjta si çdo palë tjetër dhe nuk duhet të gëzojnë pozitë të privilegjuar që e shkel parimin e barazisë së armëve si pjesë e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
45. Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së vet gjyqësore, në veçanti Rastit KI 108/10, Fadil Selmanaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009, me ç'rast konstatoi se *“parashtruesi është dashur të thirret në procedurë gjyqësore jo vetëm për të pasur njohuri për ekzistimin e saj, por edhe për t'i parashtruar argumentet dhe provat gjatë rrjedhës së procedurës”*.
46. Sa i përket rasti në fjalë, parashtruesi nuk ka mundur ta ushtrojë të drejtën e tij për gjykim të drejtë pa qenë i pranishëm në këtë procedurë në Gjykatën Supreme. Prandaj, duke mos e njoftuar parashtruesin për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori publik, dhe duke mos e thirrur atë si palë në procedurë në Gjykatën Supreme, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e vet të 3 shtatorit 2010, shkeli të drejtën e parashtruesit për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (1) të KEDNJ-së.
47. Sa u përket çështjeve të tjera të ngritura në kërkesë, Gjykata vëren që parashtruesi mund të ngrejë çështje të tilla në procedurë në Gjykatën Supreme.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

- I. E shpall kërkesën të pranueshme;
- II. Konstaton që ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- III. E shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010;
- IV. Ia kthen atë Aktgjykim për rishqyrtim Gjykatës Supreme në pajtim me aktgjykimin e kësaj gjykate;
- V. Mbetet fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të atij Urdhri;
- VI. Urdhëron që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VII. Deklaron që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

